



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 10

Datë: 01. 03. 2024.

Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve Nr. 05, 06 dhe 07/2024**
- 3. Aktivitetet e Zyrës:**

Rekomandimi për regjistrim të partisë politike "SRPSKI NARODNI POKRET".

- 4. Raportet e Këshillave të KQZ-së:**

2.1. Këshilli për Çështje Ligjore

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të kuvendit komunal në Prishtinë

2.2. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

-Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së në punëtorinë “Mbikëqyrja e Financave të Partive Politike” në Pragë, Republika Çeke.

2.3. Komiteti i Auditimit

- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës të KA për vitin 2024”

- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës i KA për vitin 2023

5. Vlerësimi vjetor i punës së Zëdhënësit të KQZ.

6. Të ndryshme

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Fillimisht, kryetari Radoniqi, në interes të prezencës së vërejtshme të mediave, tha se “peticioni” javën që vjen, do ta trajtojmë. Procesi, ende nuk ka përfundua dhe, mbasi që në javën që vjen do ta kemi në mbledhje, dhe do shqyrtohet edhe kjo pikë. Pastaj, kryetari Radoniqi paraqiti agjendën e mbledhjes. Pastaj, ai pyeti se “jeni dakord” që pika nga KMJ të vendoset pas pikës së “komitetit të auditimit”, meqë edhe kjo është e mbyllur dhe të jetë në radhë me pikën për vlerësimin vjetor të zëdhënësit? Anëtarët u pajtuan. Alban Krasniqi, po ashtu propozoi që “pika 5” të tërhiqet për mbledhjen e radhës, meqë nuk janë formularët e përditësuar dhe nuk ka kaluar në personel. Si njoftim, e shtoj edhe një pikë nga KMJ për vëzhgimin e zgjedhjeve në vendet e huaja...

Me propozime dhe plotësime, anëtarët e KQZ –së me 11 vota për miratuan rendin e ditës. Pas vërejtjeve lidhur me vonesat nga z. Kurteshi, të z. Radoniqi dhe të znj. Llabani e cila tha se nuk ka qenë prezent në mbledhjen nr. 6, u miratuan procesverbalet nr. 05, 06 dhe 07/2024.

2. Aktivitetet e Zyrës:

Rekomandimi për regjistrim të partisë politike ‘‘‘

Besnik Buzhala, tha se iniciativa politike “Srpski narodni pokret” më 31 janar, që udhëhiqet nga Milja Bishevac ka dorëzuar aplikacionin për regjistrim, siç kërkohet me rregullore. Zyra, ka shqyrtuar dokumentacionin në tërësi. Pas verifikimeve përfimtare, pagesës së takës, dhe shqyrtimit publik dhe

dokumentacioni është në përputhje me rregullat dhe ligjet në fuqi, ne rekomandojmë KQZ-në për regjistrim.

Me 11 vota për, u aprovua rekomandimi i Zyrës.

3. Raportet e Këshillave të KQZ-së:

2.1. Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të kuvendit komunal në Prishtinë:

Sami Hamiti, kryesues i këtij këshilli, tha se është shqyrtuar kërkesa e kryesuesit të kuvendit të komunës së Prishtinës për zëvendësim. Janë plotësuar kushtet dhe ne rekomandojmë për zëvendësim:

Kreshnik Radoniqi: Besë Prestreshi nga subjekti politik LDK, emërohet anëtare e re e kuvendit komunal të Prishtinës, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashme znj. Donjeta Dragushen.

Me 11 vota për, rekomandohet ky zëvendësim.

4. Komiteti i Auditimit

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës i KA për vitin 2023:

Sami Kurteshi, tha se këshilli ka shqyrtuar këto pika, dhe se dokumentet u janë dërguar. Dokumenti i parë është raportit të Punës i KA për vitin 2023. Gjatë këtij viti KO ka mbajtur gjashtë takime të rregullta. Kemi ushtruar përgjegjësitë e plota me ligj, me udhëzime administrative. E keni raportin për ta pa se çka kemi punue...

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës të KA për vitin 2024”:

Në mbledhjen e fundit që e kemi mbajtur në muajin shkurt, e kemi trajtue planin e Punës së KA për vitin 2024. Z, Kurteshi, pasqyroi përmbajtjen e planit të punës, Janë çështje të planifikuara nga auditori, ashtu si edhe nga komitetit...

Alban Krasniqi, tha se KQZ ka të drejtë me kërkua auditim ad – hok, kështu që kjo të jetë e nënkuptueshme. Kjo të jetë e definueme, të mos kemi dilema sepse, këtë funksion ka auditimi. Ne, mund të kërkojmë auditime shtesë, pa e cenuar planin e punës së auditorit.

Kreshnik Radoniqi: E hedh në votim Planin e Punës së KA...? Kush është për...?

Me 11 vota për, u miratua...

Gjithashtu, edhe Raporti i Punës i KA për vitin 2023, u miratua me 11 vota – unanimitisht...

Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së në punëtorinë “Mbikëqyrja e Financave të Partive Politike” në Pragë, Republika Çeke:

Kreshnik Radoniqi: Kemi një ftesë për pjesëmarrje në punëtorinë “Mbikëqyrja e Financave të Partive Politike” në Pragë, Republika Çeke. Në këshill e kemi shqyrtuar. IFES, nuk i mbulon të gjitha shpenzimet, por ose rrugën ose fjetjen.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan vendimin që të marrë pjesë Besnik Buzhala, drejtor i Zyrës dhe një zyrtar tjetër.

Kreshnik Radoniqi, tha se në këshill është trajtuar edhe “lista” e vendeve që do të kenë zgjedhje këtë vit, dhe se këshilli nuk ka marrë ndonjë vendim, por që meqë ka shumë vende që kanë zgjedhje, të shihet se ku kemi më shumë interes...

Alban Krasniqi: Që tani, ti kërkojmë informacionet: cili a sistemi, çfarë zgjedhjesh, ku kishim pasur interesim më shumë...

Në vijim, mbledhja u zhvillua me dyer të mbyllura...